REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit së Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-400/01-49725 të datës 29.09.2026 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Help –Hilfe zur Selbsthilfe e.V, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2026, të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE HELP - HILFE ZUR SELBSTHILFE E.V

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **42.875.00 €** (katërdhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë euro) Organizatës Help –Hilfe zur Selbsthilfe e.V, konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-400/01-49725 të datës 29.09.2026 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Help –Hilfe zur Selbsthilfe e.V.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-400/01-49725 të datës 29.09.2026 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Help – Hilfe zur Selbsthilfe e.V. me qëllim të realizimit të projektit të përbashkët me titull "Punë dhe Aftësi për parandalimin e migrimit në Kosovë" i financuar nga Zyra Federale Gjermane për Migracion dhe Refugjatë (BAMF) dhe i bashkëfinancuar nga Help, Komuna dhe përfituesit e projektit ku Komuna e Lipjanit obligohet të participojë me shumën e mjeteve financiare si në pikën **I** të këtij Vendimi.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara për vitin 2026 për Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim, fondi burimor 21/613/48003/200/00000/0411.

M

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim .

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim - Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit së Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-400/01-49725 të datës 29.09.2026 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Help –Hilfe zur Selbsthilfe e.V.

Marrëveshja e cekur është lidhur me qëllim të realizimit të projektit të përbashkët me titull " Punë dhe Aftësi për parandalimin e migrimit në Kosovë" i financuar nga Zyra Federale Gjermane për Migracion dhe Refugjatë (BAMF) dhe i bashkëfinancuar nga Help, Komuna dhe përfituesit e projektit, ku në kuadër të këtij projekti planifikohet të mbështeten sipërmarrës në synimet e tyre për të filluar ose zhvilluar biznesin e tyre.

Projekti "Punë dhe Aftësi për Parandalimin e Migrimit në Kosovë" synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe parandalimin e migrimit të parregullt përmes krijimit të mundësive për punësim, vetëpunësim dhe zhvillim të biznesit në Komunën e Lipjanit.

Mbështetja do t'u ofrohet sipërmarrësve ekzistues dhe atyre potencialë, me fokus të veçantë tek gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet jo shumicë, personat e papunë dhe grupet e tjera të cenueshme.

Në kuadër të projektit, në territorin e Komunës së Lipjanit do të mbështeten 35 përfitues përmes granteve, në vlerë deri 2500 euro për një përfitues të përzgjedhur përmes një procedure transparente dhe konkurruese.

Mbështetja do të përfshijë:

1. Donacione në formën e pajisjeve për zhvillimin e biznesit;
2. Trajnime sipërmarrëse, profesionale dhe mentorim sipas nevojave të përfituesve;
3. Monitorimin dhe këshillimin e vazhdueshëm të bizneseve të mbështetura;
4. Mbështetje për formalizimin, zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 400/01-52123
Lipjan, më 14.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN

PRANUAR ME:
PRIMLJENO DANA: 29.09.2026

NJËSIA ORGANIZATIVE JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01-	4100/01-	49725	

Bundesamt für Migration und Flüchtlinge

Help
Hilfe zur Selbsthilfe e.V.

Marrëveshje Bashkëpunimi
në mes të:

Cooperation Agreement
between:

Komuna e Lipjanit /Lipjan Municipality
Me seli ne / *With the registered seat at*
Rr/Str: "Shqipëria" nr.28, Lipjan
Përfaqësuar nga / *Represented by*
Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës/*Mayor*
(tutje referuar si – „Komuna" *hereinafter "Municipality")*

dhe / *and*

Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V.
Me seli ne / *With the registered seat at*
Prishtine, Ulpiana, rr/str: Zija Shemsiu 102/9
Përfaqësuar nga / *Represented by*
Shqipe Breznica, Drejtoreshe Nacionale/*Country Director*
(tutje referuar si – „Help"; *hereinafter „Help")*

Në kuadër te projektit
"Punë dhe Aftësi për Parandalimin e Migrimit në Kosovë"
Within the project
"Jobs and Skills for Migration Prevention in Kosovo"

Neni 1.

Subjekti i Marrëveshjes

Subjekti i kesaj Marreveshjeje per Bashkefinancimin dhe Zbatimin e Projektit (ne vijim "Marreveshja") esnte rregullimi i bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Lipjanit (në vijim "Komuna") dhe Help – Hilfe zur Selbsthilfe e.V. (në vijim "Help") për zbatimin e projektit "Punë dhe Aftësi për Parandalimin e Migrimit në Kosovë" (në vijim "Projekti"), i financuar nga Zyra Federale Gjermane për Migracion dhe Refugjatë (BAMF) dhe i bashkëfinancuar nga Help, Komuna dhe përfituesit e projektit.

Palët pajtohen që Projekti do të zbatohet në përputhje me këtë Marrëveshje, Marrëveshjen e Grantit me BAMF, dokumentin e miratuar të projektit, procedurat e Help-it dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Bashkëpunimi ndërmjet Komunës dhe Help do të përfshijë:

- bashkëfinancimin e projektit sipas përgjegjësive të përcaktuara në këtë Marrëveshje;
- identifikimin dhe përzgjedhjen e përfituesve përmes një procedure transparente dhe konkurruese;
- zbatimin, monitorimin dhe koordinimin e aktiviteteve të projektit;
- bashkëpunimin në raportimin dhe promovimin e rezultateve të projektit.

Article 1

Subject of the Agreement

The subject of this Co-financing and Project Implementation Agreement (hereinafter referred to as the "Agreement") is to regulate the cooperation between the Municipality of Lipjan (hereinafter referred to as the "Municipality") and Help – Hilfe zur Selbsthilfe e.V. (hereinafter referred to as "Help") for the implementation of the project "Jobs and Skills for Preventing Migration in Kosovo" (hereinafter referred to as the "Project"), funded by the German Federal Office for Migration and Refugees (BAMF) and co-financed by Help, the Municipality, and the Project beneficiaries.

The Parties agree that the Project shall be implemented in accordance with this Agreement, the Grant Agreement concluded with BAMF, the approved Project Document, Help's internal procedures, and the applicable legislation of the Republic of Kosovo.

The cooperation between the Municipality and Help shall include:

- Co-financing the Project in accordance with the responsibilities outlined in this Agreement;
- Identifying and selecting Project beneficiaries through a transparent and competitive selection process;
- Implementing, monitoring, and coordinating Project activities;
- Cooperating in the reporting and promotion of the Project's results.

Neni 2.

Shpjegim i shkurtër i projektit

Projekti "Punë dhe Aftësi për Parandalimin e Migrimit në Kosovë" synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe parandalimin e migrimit të parregullt përmes krijimit të mundësive për punësim, vetëpunësim dhe zhvillim të biznesit në Komunën e Lipjanit.

Mbështetja do t'u ofrohet sipërmarrësve ekzistues dhe atyre potencialë, me fokus të veçantë tek gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet jo shumicë, personat e papunë dhe grupet e tjera të cenueshme.

Në kuadër të projektit, në territorin e Komunës së Lipjanit do të mbështeten 35 përfitues përmes granteve, në vlerë prej 2500 eurosh për një përfitues të përzgjedhur përmes një procedure transparente dhe konkurruese.

Mbështetja do të përfshijë:

1. Donacione në formën e pajisjeve për zhvillimin e biznesit;
2. Trajnime sipërmarrëse, profesionale dhe mentorim sipas nevojave të përfituesve;
3. Monitorimin dhe këshillimin e vazhdueshëm të bizneseve të mbështetura;
4. Mbështetje për formalizimin, zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Zbatimi i aktiviteteve të projektit do të financohet përmes bashkëfinancimit ndërmjet Zyrës Federale Gjermane për Migracion dhe Refugjatë (BAMF), Help, Komunës së Lipjanit dhe përfituesve të projektit, në përputhje me buxhetin e miratuar të projektit dhe këtë Marrëveshje.

Help do të kontribuojë financiarisht me shumën prej EUR 44,625.00, ndërsa Komuna e Lipjanit do të kontribuojë financiarisht me shumën prej EUR 42,875.00, sipas buxhetit të miratuar të projektit dhe kësaj Marrëveshjeje.

Article 2.

Short Explanation of the Project

The project "Jobs and Skills for Preventing Migration in Kosovo" aims to contribute to sustainable socio-economic development and the prevention of irregular migration by creating opportunities for employment, self-employment, and business development in the Municipality of Lipjan.

Support will be provided to existing and aspiring entrepreneurs, with a particular focus on women, youth, persons with disabilities, non-majority communities, unemployed persons, and other vulnerable groups.

Under the project, 35 beneficiaries in the Municipality of Lipjan will receive grants worth EUR 2,500 each, following a transparent and competitive selection process.

The support will include:

1. In-kind grants in the form of equipment for business development;
2. Entrepreneurship and vocational training, as well as mentoring tailored to the beneficiaries' needs;
3. Continuous monitoring and advisory support for the supported businesses;
4. Assistance with business formalization, expansion of economic activities, and the creation of new employment opportunities.

The implementation of the Project activities shall be financed through co-financing by the German Federal Office for Migration and Refugees (BAMF), Help, the Municipality of Lipjan, and the Project beneficiaries, in accordance with the approved Project budget and this Agreement.

Help shall provide a financial contribution for EUR 44,625.00. In contrast, the Municipality of Lipjan shall provide a financial contribution of EUR 42,875.00, in accordance with the approved Project budget and this Agreement.

Neni 3.

Financimi dhe Zbatimi i Projektit

Komuna dhe Help, do të bashkë financojnë projektin në përputhje me buxhetin e miratuar të projektit dhe këtë Marrëveshje. Vlera totale e investimit në kuadër të këtij projekti në Komunën e Lipjanit është EUR 87,500.00. Nga kjo shumë, Komuna do të bashkë financoje 49% të vlerës totale të investimit, përkatësisht EUR 42,875.00, ndërsa Help, do të financojë 51%, përkatësisht EUR 44,625.00, në përputhje me

Marrëveshjen e Grantit me Zyrën Federale Gjermane për Migracion dhe Refugjatë (BAMF), rregullat e donatorit dhe legjislacionin në fuqi.

Kontributi financiar i Komunës do të transferohet në llogarinë e veçantë të projektit të Help-it, (IBAN/llogaria nr. 1110339387010117, ProCredit Bank), në një këst, pas përzgjedhjes së përfituesve dhe pranimit të kontratave të nënshkruara të këtyre përfituesve.

Help merr përsipër që kontributin e Komunës ta përdorë ekskluzivisht për aktivitetet e projektit, të mbajë evidencë të veçantë financiare për këto fonde dhe t'i raportojë Komunës për përdorimin e tyre në përputhje me këtë Marrëveshje. Komuna do të emërojë një person kontaktues për koordinimin e projektit dhe do të bashkëpunojë me Help gjatë zbatimit të aktiviteteve.

Article 3.

Project Financing and Implementation

The Municipality and Help shall co-finance the Project in accordance with the approved Project budget and this Agreement.

The total investment under this Project in the Municipality of Lipjan amounts to EUR 87,500.00. Of this amount, the Municipality shall co-finance 49% of the total investment, equivalent to EUR 42,875.00, while Help shall finance the remaining 51%, equivalent to EUR 44,625.00, in accordance with the Grant Agreement concluded with the German Federal Office for Migration and Refugees (BAMF), the donor's rules and regulations, and the applicable legislation.

The Municipality's financial contribution shall be transferred in a single instalment to Help's dedicated project bank account (IBAN/Account No. 1110339387010117, ProCredit Bank), following the selection of beneficiaries and receipt of their signed contracts.

Help undertakes to use the Municipality's financial contribution exclusively for the implementation of the Project activities, to maintain separate financial records for these funds, and to report to the Municipality on their utilization in accordance with this Agreement. The Municipality shall designate a contact person responsible for coordinating the Project and shall cooperate with Help throughout the implementation of the Project activities.

Neni 4.

Monitorimi dhe Raportimi

Help do të jetë përgjegjëse për monitorimin e përgjithshëm të projektit, organizimin e procesit të përzgjedhjes së përfituesve, monitorimin e zbatimit të aktiviteteve dhe raportimin ndaj BAMF-it, në përputhje me Marrëveshjen e Grantit dhe procedurat e brendshme të Help-it.

Përfituesit do të përzgjidhen përmes një procedure transparente, konkurruese dhe të paanshme, në përputhje me kriteret e miratuara të projektit. Përzgjedhja do të bëhet nga një Komision i përbashkët i palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje, ku Komuna e Lipjanit do të përfaqësohet së paku nga një anëtar i caktuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

Përparësi do t'u jepet sipërmarrësve ekzistues dhe potencialë, grave, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve jo shumicë, personave të papunë dhe grupeve të tjera të cenueshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e projektit.

Komuna do t'i ofrojë Help-it, në kohën e duhur, të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm lidhur me aktivitetet e saj dhe kontributin financiar, me qëllim të monitorimit të projektit dhe përmbushjes së kërkesave të raportimit ndaj donatorit.

Help do t'i dorëzojë Komunës një raport përfundimtar narrativ dhe financiar brenda tre (3) muajve nga përfundimi i projektit.

Palët do të bashkëpunojnë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit, do të shkëmbejnë rregullisht informacion dhe do të mundësojnë monitorimin, verifikimin dhe auditimin e aktiviteteve dhe dokumentacionit përkatës, në përputhje me këtë Marrëveshje, Marrëveshjen e Grantit me BAMF-in dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Article 4.

Monitoring and Reporting

Help shall be responsible for the overall monitoring of the Project, the organisation of the beneficiary selection process, monitoring the implementation of Project activities, and reporting to BAMF, in accordance with the Grant Agreement and Help's internal procedures.

Beneficiaries shall be selected through a transparent, competitive and impartial process, in accordance with the approved Project criteria. The selection shall be carried out by a joint committee of the Parties to this Agreement, in which the Municipality of Lipjan shall be represented by at least one member appointed by the Directorate for Economy and Development.

Priority shall be given to existing and aspiring entrepreneurs, women, youth, persons with disabilities, non-majority communities, unemployed persons and other vulnerable groups, in accordance with the criteria set out in the Project documentation.

The Municipality shall provide Help, in a timely manner, with all information and documentation necessary in relation to its activities and financial contribution, for the purposes of Project monitoring and fulfilment of donor reporting requirements.

Help shall submit a final narrative and financial report to the Municipality within three (3) months following completion of the Project.

The Parties shall cooperate throughout the Project implementation period, regularly exchange information, and facilitate the monitoring, verification and auditing of Project activities and related documentation, in accordance with this Agreement, the Grant Agreement with BAMF and the applicable legislation of the Republic of Kosovo.

Neni 5

Konfidencialiteti

Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha informacioneve, dokumenteve dhe të dhënave financiare, teknike apo personale, të shkëmbyera, përpunuara ose të krijuara gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, të cilat nuk janë të disponueshme publikisht. Informacioni konfidencial do të përdoret vetëm për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk do t'u zbulohet palëve të treta pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër, përveç rasteve kur zbulimi kërkohet sipas legjislacionit në fuqi ose nga autoritetet kompetente, BAMF-i apo auditorët e autorizuar në kuadër të monitorimit, kontrollit dhe auditimit të projektit. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit mbetet në fuqi edhe pas përfundimit ose ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje.

Article 5

Confidentiality

The Parties undertake to maintain the confidentiality of all non-public information, documents, and financial, technical, or personal data exchanged, processed, or generated during the implementation of this Agreement. Confidential information shall be used solely for the purposes of implementing this Agreement and shall not be disclosed to any third party without the prior written consent of the other Party, except where such disclosure is required by applicable law or by competent authorities, the German Federal Office for Migration and Refugees (BAMF), or authorised auditors in connection with the monitoring, control, or audit of the project. The obligation to maintain confidentiality shall remain in force after the completion or termination of this Agreement.

Neni 6.

Kohëzgjatja, Ndryshimet dhe Ndërprerja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe mbetet në fuqi deri më 30.04.2027, përveç nëse ndërpritet më herët sipas dispozitave të saj. Çdo ndryshim ose plotësim i kësaj Marrëveshjeje bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve, përmes anekseve ose amendamenteve që bëhen pjesë përbërëse e saj. Në rast të ndryshimeve në Marrëveshjen e Grantit me BAMF, legjislacionin në fuqi ose rrethanat që ndikojnë në zbatimin e projektit, palët mund të bien dakord për amendamentimin e kësaj Marrëveshjeje. Secila palë mund ta ndërpresë Marrëveshjen me njoftim paraprak me shkrim prej 30 (tridhjetë) ditësh, me kusht që kjo të mos cenojë detyrimet ndaj donatorit ose aktivitetet në vazhdim. Në rast ndërprerjeje, palët do të bashkëpunojnë për përmbylljen e rregullt të projektit dhe përmbushjen e detyrimeve financiare dhe raportuese.

Article6

Duration, Amendments, and Termination of the Agreement

This Agreement shall enter into force on the date of its signature by both Parties and shall remain in effect until 30.04.2027, unless terminated earlier in accordance with its provisions. Any amendment or modification to this Agreement shall be made only by mutual written agreement of the Parties through annexes or amendments, which shall form an integral part of this Agreement. In the event of amendments to the Grant Agreement with the German Federal Office for Migration and Refugees (BAMF), changes in the applicable legislation, or other circumstances affecting the implementation of the Project, the Parties may agree to amend this Agreement accordingly. Either Party may terminate this Agreement by providing thirty (30) days' prior written notice, provided that such termination does not adversely affect the Parties' obligations towards the donor or the ongoing implementation of Project activities. In the event of termination, the Parties shall cooperate to ensure the orderly closure of the Project and the fulfilment of all outstanding financial and reporting obligations.

Neni 7.

Mosmarrëveshjet

Palët do të përpiqen të zgjidhin çdo mosmarrëveshje që lind nga ose lidhet me këtë Marrëveshje përmes konsultimeve dhe negociatave në mirëbesim. Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim nuk arrihet zgjidhje, mosmarrëveshja do t'i nënshtrohet juridiksionit të Gjykatës Themelore kompetente në Prishtinë, sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës.

Article7

Dispute Resolution

The Parties shall make every effort to resolve any dispute arising out of or in connection with this Agreement through consultations and negotiations conducted in good faith. If no resolution is reached within thirty (30) days following written notification of the dispute, the dispute shall be submitted to the jurisdiction of the competent Basic Court in Prishtina, in accordance with the applicable legislation of the Republic of Kosovo.

Neni 8.

Gjuha

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të dy versionet kanë vlefshmëri të barabartë juridike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim, palët do të përpiqen ta zgjidhin atë me marrëveshje. Nëse nuk arrihet marrëveshje, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë. Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale identike, nga një për secilën palë.

Article 8.

Language

This Agreement has been drawn up in the Albanian and English languages, both versions being equally authentic and legally binding. In the event of any inconsistency or discrepancy in interpretation between the two language versions, the Parties shall endeavour to resolve it by mutual agreement. If no agreement can be reached, the English language version shall prevail. This Agreement is executed in two (2) identical original counterparts, with one (1) original copy being retained by each Party.

Data/*Date*: 29.09.2026

Në/In Lipjan,

Për Komunën e Lipjanit /
For Lipjan Municipality
Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës/*Mayor*

Për Help / *For Help*
Shqipe Breznica
Drejtoreshë Nacionale/
Country Director